

**Shqipëri
Programi për
Decentralizim dhe
Zhvillim Lokal (dldp)
në Rajonet e
Shkodrës dhe Lezhës**

**Plani Vjetor i Punës (Korrik
2010 – Dhjetor 2011)**

Përmbledhje

Shkodër/Bern, Korrik 2010



Shkurtime

SHSHK	Shoqata Shqiptare e Komunave
SHSHB	Shoqata Shqiptare e Bashkive
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ADF	Fondi Shqiptar për Zhvillim
SH	Shqipëri
ANTTARC	Qendra Shqiptare e Burimeve për trajnime kombëtare dhe asistencë teknike
KK	Komiteti Koordinues
KE	Këshilli i Evropës
dldp	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal
DSKD	Departamenti i Strategjisë dhe Koordinimit të Donatorëve (Zyra e Kryeministrit)
KE	Komisioni Evropian
EiG	Barazi Gjinore
IC	Intercooperation
IMC	Bashkëpunim ndërbashkiak
ITPA	Instituti për Trajnim të Administratës Publike
IPA	Instrumenti për para-aderim (KE)
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
MF	Menaxhim Financiar
MNE	Mal i Zi
MB	Ministria e Brendshme
MoU	Memorandum Mirëkuptimi
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSSH	One Stop Shop
PCM	Menaxhim i Ciklit të Projektit
PMU	Njësi e Menaxhimit të Programit
APP	Agjencia e Prokurimeve Publike
ProDoc	Dokumenti i Programit
RDCCS	Strategjia për zhvillim rajonal 2008-2013
SC	Komitet Drejtues
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SDP	Plan Strategjik për zhvillim
SP	Ofrues Shërbimesh
SWG	Grup sektorial pune
TSËG	Grup Pune i Sektorit Teknik
URI	Instituti i kërkimit Urban
BB	Banka Botërore
PVP	Plan Vjetor Pune

Lënda

Shkurtime.....	I
Të dhënat e Projektit	3
2. Përmbledhje Ekzekutive.....	4
3. Prezantim i dldp-së dhe objektivat kryesorë	6
4. Plani Vjetor i Punës 2010/11	8
Outcome 1 (sipas Dokumentit të Programit).....	9
Outcome 2 (sipas Dokumentit të Programit).....	10
7 Tema Transversale	12

Të dhënat e Projektit

Emri i programit	Programi për Zhvillim dhe Decentralizim Lokal (dldp) në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës
Agjencia donatore	Agjencia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim (SDC) Divizioni i Ballkanit Perëndimor Freiburgstrasse 130 3003 Bernë Zvicër Tel. +41 31 322 44 05, Fax +41 31 323 59 33 SDC/SECO Zyra e Bashkëpunimit Zviceran c/o Ambasada e Zvicrës Rruga Brigada e VIII P2/2/1 Tirana Shqipëri Tel. +355 4 240 102, Fax +355 4 240 103
Agjencia zbatuese	INTERCOOPERATION Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Maulbeerstrasse 10 P.O. Box 6724 3001 Bern Zvicër T +41 31 385 10 10 F +41 31 385 10 09 www.intercooperation.ch Intercooperation në Shqipëri L. Kongresi Përmetit Rruga Oso Kuka Nr.11 Shkodra, Albania T/F: +355 22 50 999 / 50 247
Numri i Programit i SDC	Nr. i Referencës 7F-04382.02
Partnerët kryesorë të programit	Njësi të Qeverisjes Lokale (bashki e komuna) në rajonin e Shkodrës dhe Lezhës. Shqipëria e Veriut, Shoqata e Bashkive dhe Komunave të Shqipërisë, Ministria e Brendshme.
Kohëzgjatja	Mars 2010 – Shkurt 2013
Kuadri i marrëveshjes	Kuadri i Marrëveshjes bilaterale qeveri me qeveri mes Shqipërisë dhe Zvicrës. Marrëveshja e projektit me Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë
Kontrata e projektit	Mandat i SDC-së dhënë Intercooperation

2. Përmbledhje Ekzekutive

Projekti për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (dldp) filloi fazën e dytë në mars të vitit 2010, e cila do të përfundojë në shkurt të vitit 2013 (afat 3 vjet). Projekti përfshin 33 Njësi të Qeverisjes Vendore në Shkodër dhe në 21 Njësi në Qarkun e Lezhës. Popullsia totale e rajonit është rreth 554 000 banorë, 40% e të cilëve jetojnë në zona urbane.

Qëllimi i dldp-së është: ***forcimi i kapaciteteve të bashkive dhe komunave në Shkodër dhe Lezhë, gjë e cila do kontribuonte në përmirësimin e zhvillimit rajonal në Shqipërinë e Veriut dhe në reformën për decentralizim në nivel kombëtar.***

Dldp-ja synon modernizimin e Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe nxitjen e bashkëpunimit ndër-NJQV. DLDP-ja ka një Zyrë Menaxhimi për projektet dhe një Antenë në Tiranë për dialogun mbi politikat dhe shpërndarjen e eksperiencave lokale në nivel kombëtar.

Faza e dytë e dldp-së do të ketë ndryshim në përfaqje: menaxhimi i projekteve nga stafi lokal (e parashikuar fillimisht për fazën 3), rol më të fortë si lehtësues në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve / konsulentët, mbështetje sipas kërkesave (për NJQV-të, si dhe shoqatat e NJQV-ve, hartimi i grafikut të aktiviteteve në mënyrë fleksibël dhe me orientim produkt/proces). Pesë linjat kryesore të aktivitetit të dldp-së janë: (1) planifikim strategjik dhe hartim i buxhetit me afat të mesëm, (2) menaxhim financiar i përmirësuar (mbledhja e taksave) (3) menaxhim i mbetjeve (mbledhja, kompostimi/riciklimi, minimizimi, monitorimi), (4) menaxhim i ciklit të projektit dhe modernizim i informimit dhe komunikimit.

Situata në Shqipëri karakterizohet nga një paqëndrueshmëri politike (kriza parlamentare ka çuar në ndarjen e shoqatave të NJQV-ve), ka rrezik që fondet për NJQV-të të reduktohen për shkak të nivelit të lartë të borxhit në Shqipëri. Zgjedhjet vendore që parashikohen të mbahen në prill/maj 2011 janë dhe mundësi e mirë dhe risk për DLDP-në: drejtues të rinj të motivuar nga njëra anë dhe humbja e drejtuesve të trajnuar nga ana tjetër, pasi pritet që një numër i madh kryetarësh bashkie dhe anëtarësh këshilli të ndryshojnë. Koordinimi i donatorëve do të mbetet një sfidë për shkak të numrit të lartë të aktorëve dhe fillimi i Programit komplementar për Zhvillim Rajonal (të bashkë-financuar nga SDC-ja dhe nën drejtimin e ADA-s) nuk pritet të fillojë para vitit 2011.

Rezultatet kryesore që priten të arrihen gjatë periudhës 18 mujore të këtij Plani Vjetor Pune (korrik 2010 – dhjetor 2011) në nivel NJQV-sh janë: konkursi për praktikën më të mirë me dokumentacionin e praktikave më të mira, përcaktimi i 12-15 qendrave kompetence që të përdoren për NJQV-të që do kenë mundësi të trajnohen/këshillohen e të krijojnë praktika të mira më tej, shqyrtim i planeve strategjike (5) dhe lidhje më e mirë me hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm, përmirësim i menaxhimit financiar dhe fiskal të NJQV-ve dhe ofrimi i shërbimeve (veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve në 2-3 NJQV), krijimi i një skeme grantesh të dldp-së duke mbështetur 10-12 projekte në raundin e parë që do prezantohet në vjeshtë 2010.

Rezultatet kryesore që priten në nivel kombëtar janë: forcimi i njohurive nëpërmjet takimeve kombëtare (tavolina tematike të rumbullakëta si dhe publikime të ndryshme, kurrikula (ca. 8) që mbulojnë pesë linjat e aktivitetit dhe bashkëpunim i ngushtë dhe mbështetje për shoqatat e NJQV-ve (ShShB dhe ShShK). Për më tepër dldp-ja do të lehtësojë koordinimin e sektorëve nën drejtimin e SCO-A-së dhe do të mbështesë me inpute teknike dhe ekspertizë dialogun mbi politikat, duke kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e ligjëbërjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të reformës së decentralizimit.

Tema transversale: Tema e çështjeve gjinore do të trajtohet në bashkëpunim të ngushtë me UNIFEM-in, EIG-në dhe NDI-në duke marrë parasysh zgjedhjet lokale që do zhvillohen në prill/maj 2011. Pritet të rritet numri i grave në këshillat e NJQV-ve në fushën kryesore të projektit dhe transparenca, pasi pjesëmarrja e qytetarëve do të trajtohet në gjitha linjat e veprimit.

Menaxhimi dhe drejtimi: duke pasur parasysh fazën e tranzicionit dhe kohëzgjatjen e madhe (prej 18 muajsh) do të ketë nevojë për fleksibilitet dhe planifikim të radhës. Komiteti drejtues kombëtar përbëhet nga 10-12 anëtarë nga niveli lokal dhe kombëtar, të cilët do jenë përgjegjës për vendimmarrje strategjike. Një komitet koordinimi me nivel teknik më të lartë përbëhet nga 15-20 anëtarë (duke përfshirë një përfaqësim më të gjerë të NJQV-ve të rajonit të projektit).

Buxheti i përgjithshëm për këtë periudhë 18 mujore është 2 766 439 franga zvicerane, në një linjë me buxhetin e përcaktuar në Dokumentin e Programit të dldp-së (janar 2010).

3. **Prezantim i dldp-së dhe objektivat kryesorë**

Programi për Zhvillim dhe Decentralizim Lokal (dldp) është pjesë e Strategjisë Zvicerane të Bashkëpunimit SDC/SECO me Shqipërinë (fusha demokratizimi dhe sundimi i ligjit). Projekti mbështet procesin në zbatim e sipër të decentralizimit në vend, duke mundësuar konsolidimin e demokracisë dhe sigurimin e standardeve evropiane të shërbimeve publike për qytetarët, si një element i rëndësishëm i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Ky dokument i programit të fazës së 2-të të dldp-së (03/2010 - 02/2013), përcakton vizionin dhe strategjinë për arritjen e rezultateve të qëndrueshme në fund të projektit (planifikuar për vitin 2016). Objektivat e projektit përcaktohen si më poshtë:

Qëllimi i projektit: “Kapacitetet e bashkive dhe komunave në Shkodër dhe Lezhë janë forcuar duke kontribuar në një zhvillim rajonal të përmirësuar në Veri të Shqipërisë dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar”

Outcome 1: Bashkitë dhe komunat në Qarkun e Lezhës dhe Shkodrës kanë përmirësuar strukturat e tyre qeverisëse, kapacitetet dhe shërbimet e përzgjedhura lokale

Outcome 2: Praktikrat e mira janë shkëmbyer në nivel kombëtar përmes shoqatave të forcuara, duke ndikuar kështu në politikë bërje, legjislacion dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar

Nën outcome 1 janë përcaktuar pesë outpute:

- 1.1 Janë përmirësuar kapacitetet e NJQV-ve në planifikim strategjik dhe buxhetim dhe NJQV-të e përzgjedhura zbatojnë instrumente planifikimi strategjik dhe metoda, të lidhura me buxhetet vjetore dhe afatmesme.
- 1.2 Janë forcuar kapacitetet e NJQV-ve në menaxhimin fiskal dhe financiar, përfshirë dhe procesin e buxhetimit afatmesëm.
- 1.3 Janë përmirësuar shërbimet e përzgjedhura lokale administrative dhe publike duke siguruar akses të barabartë për të gjithë qytetarët, përfshi gratë, grupet e varfra e të marxhinalizuara.
- 1.4 Mekanizma inovativë, informativë dhe komunikativë janë aplikuar nga NJQV-të duke rritur transparencën dhe aksesin më të lehtë të qytetarëve ndaj shërbimeve dhe informacionit cilësor.
- 1.5 Qarku kontribuon në zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-vendor.

Nën outcome 2, janë përcaktuar katër outpute:

- 2.1 Janë identifikuar “Qendrat e kompetencave”, janë dokumentuar dhe shpërndarë praktikrat më të mira në bashki dhe komuna të tjera përmes Shoqatës së Bashkive (ShShB) dhe Komunave (ShShK).
- 2.2 Shoqatat e forcuara (ShShB dhe ShShK) janë në gjendje të përfaqësojnë interesat e qeverisë lokale: procese konsultative në hartim politikash e ligjesh

dhe ndërtimi i kapaciteteve të NJQV-ve ndikon efektivisht në zbatimin e procesit të decentralizimit

- 2.3 Praktikave të mira dhe ekspertiza e përzgjedhur kontribuon në dialogun kombëtar mbi politikën.
- 2.4 Është siguruar lidhja dhe shkëmbimi me programe dhe projekte të tjera, veçanërisht me Këshillin e Evropës.

Objektiva dhe sfida të tjera kryesore në lidhje me menaxhimin e përgjithshëm janë:

- Ndryshimi i rolit të dldp-së në lehtësues, nga zbatim dhe këshillim individual i NJQV-ve pilote drejt lehtësimit të proceseve, shkëmbimit të praktikave të mira, krijimit të rrjetit të ekspertizës dhe mësimave të përbashkëta, me një zotërim kombëtar më të fortë të NJQV-ve, ndërtuesve lokalë të kapaciteteve dhe shoqatave kombëtare të NJQV-ve;
- Zgjerim i numrit të partnerëve dhe shtrirjes gjeografike të projektit nga 8 NJQV të para-zgjedhura në të gjitha NJQV-të në dy rajonet e Shkodrës dhe Lezhës, duke pasur në fokus 12-15 qendra kompetence;
- Modele bashkëpunimi më fleksibël me një numër më të lartë NJQV-sh të bazuara në angazhim, duke përfshirë elementë konkurrimi për të shpërblyer performancën;
- Forcimi i bashkëpunimit me programe të tjera për të qenë komplementar në mbështetje të decentralizimit dhe politikave rajonale të zhvillimit;
- Lidhje të forta dhe ndikim në nivel kombëtar për të siguruar një impakt në mbarë vendin dhe për të dhënë një kontribut në politikën dhe reformat kombëtare të decentralizimit të vendit, veçanërisht nëpërmjet një përfshirje sistematike dhe mbështetje të shoqatave të qeverisjes vendore (SHSHB/SHSHK) dhe përdorimit të kanaleve të tjera si grupi i punës qeveri, sektor donatorësh që punojnë për zhvillim rajonal dhe për decentralizim, ku SDC-ja luan një rol kryesor si pikë kontakti dhe si bashkë drejtuese.


Ngritja e projektit si dhe funksioni dhe përbërja e Komitetit Drejtues dhe e Komitetit të Koordinimit Teknik ngelen për t'u vendosur.

4. *Plani Vjetor i Punës 2010/11*

Principet dhe sfidat kryesore të punës të përcaktuara në ProDoc janë akoma në fuqi dhe janë baza për këtë Plan Vjetor Pune. Ato mund të përmbliken si më poshtë:

- **Orientimi sipas kërkesës i të gjitha aktiviteteve:** Në mënyrë që të arrihet maksimizimi i zhvillimit të kapaciteteve dhe matjes së menaxhimit të njohurive duhet një përjasje me disa nivele për: a) trajnim më të përgjithshëm të një mase të gjerë stafi të NJQV-ve, b) shkëmbim të ekspertizës ndërmjet grupit të ekspertëve dhe qendrave të kompetencës dhe c) mbështetje të tryezave të rrumbullakëta dhe forumeve të shoqatave të NJQV-ve, nëse është e nevojshme dhe ekspertizë ndërkombëtare.
- **Ndryshim i rolit:** Kjo gjë do të bëhet në dy nivele: Së pari, roli kryesor i dldp-së do të kalojë nga zbatues në lehtësues, duke punuar nga afër me një sërë Ofruesish Shërbimesh (kryesisht me konsulenca të specializuara në mënyrë tematike), që ofrojnë platforma me qëllim përmirësimin e NJQV-ve të interesuara. Së dyti, dldp-ja do të ketë një fazë tranzicioni gjatë Planit Vjetor të Punës, në të cilin menaxhimi i mëparshëm i projektit nga ekspertë të huaj do t'i kalohet menaxhimit kombëtar të projektit me ekspertë shqiptarë. Ky tranzicion do të shoqërohet me një mbështetje të jashtme (KEK-CDC) si dhe nëpërmjet matjeve specifike të zhvillimit të kapaciteteve të stafit të dldp-së.
- **Promovimi i shkëmbimit dhe mësimin ndër-NJQV:** shkëmbimi i eksperiencave dhe ndër-mësimi do të mbështeten në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat e NJQV-ve. Do të zbatohet koncepti i përcaktimit të grupit të ekspertëve dhe qendrave të kompetencës. Përzgjedhja do të bëhet sipas pesë linjave për ndërhyrje me prioritet: (1) planifikim strategjik dhe buxhetim afatmesëm, (2) menaxhim financiar duke përfshirë dhe mbledhjen e taksave, (3) menaxhim të mbetjeve, (4) menaxhim të ciklit të projektit dhe (5) informim dhe komunikim. Baza për përzgjedhje është konkursi për praktikën më të mirë, rezultatet nga sondazhi kryesor dhe performanca gjatë trajnimeve/seminareve fillestare. Më tej, shkëmbimi ndër NJQV do të adresohet nëpërmjet fondeve grant të dldp-së dhe bashkëpunimit të ngushtë me dy qarqet dhe me donatorë të tjerë aktivë në rajon (p.sh CoE dhe GTZ).
- **Modalitete fikse:** kombinim i asistencës teknike (zhvillim kapacitetesh, këshillim, lehtësim i grupeve të ekspertëve, vizita pune dhe të tjera) me asistencë me bashkë-financim (fond grant i dldp-së me bazë konkurrimi).
- **Ngritja në nivel më të lartë:** eksperiencat nga faza e parë e dldp-së dhe praktikat më të mira të rajoneve do të përdoren për t'u rritur në nivel më të lartë nëpërmjet hartimit të manualeve për trajnim, broshurave, rasteve për studim ose publikimeve duke kontribuar në këtë mënyrë në dialogun për politikën kombëtare dhe ligjëbërje, të lidhura me politikën ndër sektoriale për decentralizim dhe zhvillim rajonal.

Për fazën e dytë të dldp-së është hartuar sistemi i mëposhtëm i objektivave. Janë formuluar indikatorë specifikë për nivele të ndryshme të objektivave për monitorimin e rezultateve në nivele të ndryshme dhe janë adaptuar për kohëzgjatjen aktuale të PVP.



Qëllimi i programit është:

Janë forcuar kapacitetet e bashkive dhe komunave në Lezhë e Shkodër, duke kontribuar në zhvillim rajonal të përmirësuar në Veri të Shqipërisë dhe në reformën për decentralizim në nivel kombëtar

Outcome 1 (sipas Dokumentit të Programit)

Në çfarë mase ka kontribuar dldp-ja në outcome **“Bashkitë dhe Komunitat në Qarkun e Shkodrës dhe Lezhës kanë përmirësuar strukturat e tyre të qeverisjes, kapacitetet dhe shërbimet e përzgjedhura lokale publike”** do të vlerësohet nëpërmjet shpërndarjes së output-eve të mëposhtme:

Output-e të planifikuara (OP 1.1 – 1.5) për 2010/11

- Tre NJQV të reja do të përpunojnë një plan strategjik dhe 6 NJQV do të azhurnojnë dokumentet e tyre strategjike me një metodologji të re që lidh Planin e Zhvillimit Strategjik me buxhetimin afatmesëm.
- Grupi i ekspertëve ndër NJQV (nga qendrat e kompetencave) për menaxhim financiar bëhet efektiv dhe ofron këshillim/trajnim për NJQV-të e tjera të interesuara.
- Planet për menaxhimin e mbetjeve janë përfunduar në tre NJQV dhe pesë raste studimi janë dokumentuar (mbledhje publike dhe private, kompostim/riciklim, monitorim i rrjedhjes së mbetjeve).
- Është hartuar skema e granteve të dldp-së (me procedura transparente, kritere të qarta vlerësimi dhe mbi bazë konkurrimi). Grupi i parë i 10-12 projekteve të NJQV-ve do të përzgjidhet deri në fund të vitit 2010 dhe do të këshillohet dhe monitorohet gjatë zbatimit në vitin 2011.
- Janë analizuar eksperiencat me one stop shop dhe janë krahasuar me modele të

tjera duke përfshirë qendrat e informacionit.

- NJQV-të e interesuara janë të afta të formulojnë në mënyrë të suksesshme projekt propozimet për fondet kombëtare (p.sh RDF) dhe fondet ndërkombëtare (p.sh IPA), në mbështetje të decentralizimit dhe zhvillimit rajonal.

Sfidat/çështjet

- Grafiku i drejtë dhe monitorimi i aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve do të jenë kyçe për të siguruar koherencën e programit dhe për të penguar në të njëjtën kohë një mbingarkesë për NJQV-të partnere.
- Skema e granteve do të jetë linja e aktivitetit me buxhetin më të lartë. Do të merren masa paraprake për të dhënë grantet në bazë të fizibilitetit teknik dhe financiar të projektit të propozuar.
- Zgjedhjet lokale që do mbahen në prill/maj 2011 janë një pikë e mirë fillimi për projektin (p.sh promovimi gjinor), por ndryshimet që mund të ndodhin pas zgjedhjeve jo vetëm në nivel personeli, por ndryshimet në politika mund të kenë efekte negative në reformën për decentralizim.

Outcome 2 (sipas Dokumentit të Programit)

Në çfarë mase ka kontribuar dldp-ja në outcome ***“Praktikat e mira shkëmbehen në nivel kombëtar nëpërmjet shoqatave të forcuara, duke ndikuar kështu në politikë bërje dhe ligjbërje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar”*** do të vlerësohet nëpërmjet shpërndarjes së outputeve të mëposhtme:

Output-et e planifikuara (OP 2.1 – 2.4) për 2010/11

- Përzgjedhja e “qendrave të kompetencës” në bazë të a) sondazhit të vlerësimit b) konkurseve të praktikave më të mira dhe c) seminareve tematike.
- Konkursi për praktikën më të mirë ndërmjet NJQV-ve përfundohet me shpërndarjen e shpërblimeve dhe dokumentimin e rezultateve.
- Janë organizuar të paktën 5-6 ngjare të përbashkëta (tavolina të rrumbullakëta të përbashkëta, konferenca, trajnime) me programe dhe partnerë të tjerë (p.sh SHSHB dhe SHSHK).
- Forcimi i shoqatës së NJQV-ve nëpërmjet aktiviteteve të grumbulluara: mbështetje në fushatat dhe prezencën e medias, dialog me parlamentarë dhe donatorë, përfaqësim më i fortë ndërkombëtar, etj).
- Janë mbështetur të paktën 2 iniciativa lobimi/advokimi të shoqatave të NJQV-ve me qëllim përmirësimin e ligjbërjes dhe legjislacionit për decentralizim.
- Zgjedhjet e ardhshme të brendshme të shoqatave të NJQV-ve (kryesisht SHSHB) janë përgatitur mirë dhe do të ketë proces transparent.
- Trajnim/këshillim para dhe pas zgjedhjeve i grave kandidate (për kryetare bashkie dhe anëtare këshilli) në bashkëpunim me partnerë të tjerë të tillë si NDI, UNIFEM dhe EiG.

<ul style="list-style-type: none"> • 6-8 publikime/kurrikula të prezantuara në ngjarje kombëtare (manual trajnimi, dokumentimi i praktikave të mira) në pesë fusha tematike me prioritet për dldp-në: planifikim strategjik dhe buxhetim, menaxhim financiar, menaxhim i mbetjeve, Menaxhim i Ciklit të Projektit, bashkëpunim ndër-NJQV. • Grupi i punës i Sektorit Teknik takohet rregullisht dhe eksperiencia e praktikës më të mirë shkëmbehet, duke kontribuar në dialogun mbi politikat për decentralizim me kërkesë të Ministrisë së Brendshme. • Pilotimi i një kurrikule trajnimi mbi buxhetimin afatmesëm të njehsuar nga ITAP. • Dldp mbështet SCO-A dhe Ministrinë e Brendshme në politikë bërje (aktivitete të ndryshme, përfshi. outcome 1) sipas kërkesës.
<p>Sfidat/Çështjet</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Të dyja shoqatat e NJQV-ve kanë mbështetje të gjerë donatorësh. Sfida kryesore është të ndryshojnë ndarjen e shoqatave sipas përkatësisë politike. Në këtë pikë, dldp-ja ofron mbështetje institucionale/mbështetje ndërmjetësimi, nëse një gjë e tillë kërkohet. • Koordinimi i donatorëve varet në mënyrë të ndjeshme nga njerëzit. Mbështetja e Ministrisë së Brendshme për grupet e punës të Sektorit Teknik duhet të forcohet në mënyrë që të funksionojë. • Kryerja e publikimeve të planifikuara duhet të ndahet në faza dhe disa mund të finalizohen vetëm në fillim të vitit 2012. • Reforma e decentralizimit ka pasur disa sfida gjatë statusit për pranim në BE, duke i dhënë më shumë peshë çështjeve të zhvillimit rajonal dhe nivelit rajonal si organ koordinimi. Për këtë arsye, për dldp-në është i rëndësishëm menaxhimi i drejtë (dhe shkëmbimi reciprok i informacionit) me agjencitë rajonale dhe kombëtare.

7 Tema Transversale

Në linjë me strategjinë e bashkëpunimit me SCO-A-në (2010-2013), dldp-ja ka si tema transversale *çështjet gjinore dhe qeverisjen*.

Projekti kalon nga një përjasje ad hoc me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore në një promovim më sistematik të barazisë gjinore në aktivitetet e projektit. Zgjedhjet e ardhshme lokale ofrojnë një platformë të mirë; në bashkëpunim me partnerë të tjerë (të specializuar) do të integrojmë, promovojmë dhe do të monitorojmë në mënyrë më sistematike promovimin e barazisë gjinore në fusha të ndryshme pune, p.sh.

- Metodologjia e planifikimit strategjik me ndjeshmëri gjinore dhe monitorimi i planeve strategjike të zhvillimit (përfshirja e grave, planifikim dhe monitorim me çështje të ndjeshme gjinore).
- Po vendoset bashkëpunim i ngushtë me Institutin Kombëtar Demokratik për të promovuar në mënyrë të përbashkët kandidatet gra në zgjedhjet e ardhshme lokale.
- Trajtime mbi buxhetimin të çështjeve të ndjeshme gjinore dhe aplikim mbi bazë modeli (në bashkëpunim me organizata të tjera, IKD, UNIFEM, EiG).
- Shpërndarje e shërbimeve publike për çështjet e ndjeshme gjinore (p.sh one stop shop, qendra informimi).
- Informim specifik mbi çështjet gjinore dhe komunikim me qytetarët.
- Përfshirje e temave të barazisë gjinore dhe ndërgjegjësimit në ngjarjet për zhvillim kapacitetesh, ku të jetë e mundur.
- Shpërndarja dhe promovimi i eksperiencave të përfshirjes gjinore dhe profileve të grave të suksesshme në vendimmarrje (nga agjenci të tjera dhe eksperiencat e fazës 1 të dldp-së) në bashkëpunim me SHSHB/SHSHK.

Principet e Qeverisjes së Mirë (*transparenca, përgjegjshmëria, përfshirja, efektshmëria, eficienta dhe pjesëmarrja*) do të theksohen në të gjitha aktivitetet, veçanërisht në konkursin për praktikën më të mira, përzgjedhjen e qendrave të ekselencës dhe procedurave të skemës për grante. Do të mbahet një dialog i vazhdueshëm me NJQV-të, ofruesit e shërbimeve dhe partnerët donatorë mbi përjasjet dhe ecurinë të këtyre dy temave transversale gjatë ngjarjeve M&E.